



Komuna e Klinës
Kryetari i Komunës
01Nr. 030-9201 /2020
Klinë, dt.12.03.2020

Duke u bazuar në nenin 13, 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazetën zyrtare nr. 28/2008 të publikuar me dt.04.06.2008, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës të dt. 07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/07 të datës 11.03.2020, lidhur me gjendjen e krijuar me qëllim të parandalimit nga infeksioni i Corona Virus COVID-19, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt. 12.03.2020, merr;

V E N D I M

1. **OBLIGOHEN**, te gjitha përfaqësuesit e bizneseve qe ta ndalojnë veprimtarinë e tyre duke përfshire, restorantet, klubet e natës, palestrat pishinat etj, pas orës 23:00, në përputhje më dispozitat e nenit 1 paragrafi 1.6 të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/07 të datës 11.03.2020.
2. Obligohen të përmendurit qe t'i përmbahen vendimit ne te kundërtën do te ndërmerren masat per kryerje te veprës penale kundër shëndetit publik sipas nenit 250 te Kodit Penal te Republikës së Kosovës, nr./06/L-074.
3. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/07 i datës 11.03.2020 është i plotfuqishëm në të gjitha pikat e tij dhe do te zbatohet menjëherë.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm nga koha e nxjerrjes se tij dhe do te zbatohet menjëherë.

Te njoftohet:

- Bizneset;
- Inspektorati;
- Policia e Kosovës- Klinë
- Arkivi.



Kryetari,
Zenun Elezaj